

Gjykata Supreme e Kosovës - koleggi i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Mr.sc Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Gj. B., nga Peja, të cilin e përfaqëson L. B., përfaqësues i Sindikatës së PTK-ës, kundër të paditurës P. T. K., me seli në Prishtinë, për kompensim të diferencës së pagës, lidhur me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, Ac.nr.2181/2013, datë 12.1.2016, në seancën e mbajtur më 4.4.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës P. T. K., me seli në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 2181/13, datë 12.1.2016, lidhur me pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me anulimin e aktvendimit të së paditurës Nr.01.1040-1310/2012 të datës 7.3.2012, me të cilin paditësit i është ulur grada e punës prej 9 në 8.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, Ac.nr. 2181/13, datë 12.1.2016, është aprovuar pjesërisht ankesa e të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, me seli në Prishtinë, dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Pejë, C.nr.351/2012, datë 14.6.2013, përkitazi me kamatën e gjykuar, ashtu që paditësit mbi shumën e aprovuar i pranohet norma e interesit që paguajnë bankat që operojnë në Kosovë për mjetet e depozituara në afat prej më tepër se një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 1.2.2013 e deri te pagesa e plotë, ndërsa sa i përket pjesës tjetër të aktgjykimit të ankimuar, ankesa e të paditurës është refuzuar si e pabazuar, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore Pejë, C.nr.351/2012, datë 14.6.2013, është vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë e paditura ka paraqitur revizion brenda afatit ligjor, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të

së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimet e të dy gjykatave të ndryshohen dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet apo të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të nenit 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, në bazë të kontratës së punës, nr. 01-2880-1278/2011, datë 20.10.2011, ka themeluar, me cilësi të punëmarrësit, marrëdhënie pune tek e paditura në detyrat e punës kontrollor operativ në njësinë Posta e Kosovës. Në nenin 5 të kësaj kontrate parashikohet që paditësit, për punën e kryer, t'i paguhet paga e caktuar me gradën 9, sipas vendimit të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të PTK-ës, nr.01-1630/2005, datë 28.2.2005, së paku një herë në muaj, e cila nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale.

Kryeshefi i PTK-ës, duke u bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve të datës 13.12.2011, me aktvendimin Nr.01.1040-1310/2012 të datës 7.3.2012, paditësit ia ul gradën prej 9 në 8. Kundër aktvendimit të sipërpërmendur, paditësi ka ushtruar ankesë, por përgjigje nuk ka marrë.

Bordi i Drejtorëve i të paditurës vendimin e saj e bazon në rekomandimin e aksionarit të PTK-ës - Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrisë për Zhvillim Ekonomik për reduktimin e shpenzimeve operative të personelit të së paditurës.

Pas administrimit të provave, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se me nenin 5 të kontratës së punës, lidhur mes paditësit dhe të paditurës, për punën e kryer paditësit i është caktuar paga bazë sipas gradës 9 dhe se nga palët kontraktuese duhet të respektohen dispozitat e kontratës, kurse çdo ndryshim i kësaj kontrata do të mund të bëhej vetëm me vullnetin e palëve kontraktuese. Pasi në rast konkret nuk ekziston një pajtim i tillë, aktvendimi për ndryshimin e pagës së paditësit është në kundërshtim me nenin 5 të kontratës së punës. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës - Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, nuk ka qenë ulja e pagave të punëtorëve, por ulja e shpenzimeve operative të personelit të së paditurës në raport me të hyrat e përgjithshme të PTK-ës, andaj e miratoi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar në procedurën ankimore, e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me kamatën, ndërsa pjesët e tjera aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë i ka vërtetuar.

Nisur nga një gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, i ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur e ka pranuar si të bazuar padinë e paditësit.

Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta të tilla që do të ndikonin në ligjshmërinë e tij. Sikurse të dy gjykatat, edhe kjo Gjykatë mendon se paditësi ka të drejtën e pagës që i caktohet të punësuarit me kontratë të punës në pajtim me Ligjin e Punës, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit, sipas kontratës së punës, ishte caktuar sipas gradës 9, prandaj ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me nenin 5 të kontratës së punës dhe dispozitën e nenit 55 par. 1 të Ligjit të punës (“Gazeta zyrtare” 03-L-212 – të RK), i cili parashikon se i punësuarit ka të drejtën e pagës që caktohet me kontratë të punës në pajtim me këtë Ligj, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Kërkesa e aksionarit - Qeverisë së Republikës së Kosovës – Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ka qenë që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve operative vjetore të koordinohet në përputhje me parametrat e lejuar. Rekomandimi i Ministrisë lidhur me uljen e shpenzimeve operative tek e paditura në raport me të hyrat e përgjithshme, nuk mund të jetë bazë ligjore për uljen e pagës së paditësit, pasi që në rekomandim nuk precizohen shpenzimet operative që duhen ulur dhe as që flitet për ulje pagash, ndërsa e paditura është dashur ta paraqiste një plan detaj operativ, në të cilën do të përcaktohej se cilat shpenzime mund të reduktohen dhe çfarë do të përfshinte reduktimi, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur. Përveç kësaj, në shkresat e lëndës nuk ka prova që e paditura të ketë bërë ndërhyrje në aktet normative të saj lidhur me uljen e gradave të punonjësve të saj dhe as prova të tjera nga të cilat do të rezultonte arsyeshmëria për nxjerrjen e vendimit për uljen e pagës së paditësit.

Për arsyet e cekura dhe të dhënat që gjenden në shkresat e lëndës, kjo Gjykatë i cilëson si të pabazuara thëniet e ngritura në revizion se aktgjykimet e të dy gjykatave janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Parashtrimet në revizion se e paditura ka vepruar në kuadër të qëndrimeve dhe vendimeve të marra nga aksionari i vet - Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ka bërë nivelimin e pagave në pajtim me vendimin e ligjshëm të këtij organi, kjo Gjykatë i vlerësoi si të papranueshme, për faktin se vendimi i Bordit menaxhues nuk përmban referenca ligjore dhe bazë të vlefshme juridike për marrjen e një vendimi më të favorshëm për të paditurën, ashtu siç kërkohet pa bazë në revizion.

Qëndron fakti se në raste të tjera të ngjashme gjykata e shkallës së dytë, në kolegje të ndryshme, ka vendosur ndryshe, mirëpo secili aktgjykim i gjykatës së shkallës së dytë, në mënyrë të veçantë, mund t'i nënshtrohet procedurës sipas revizionit, në mënyrë që, me vendim gjyqësor të kësaj Gjykate, të eliminohet vendimmarrja e ndryshme e gjykatës së shkallës së dytë për situata të njëjta.

Parashtrimet në revizion se: aktgjykimet e të dy gjykatave janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, parashikuar nga dispozita e nenit 182 par 2 pika (n) , lidhur me dispozitën e nenit 190.2, përkatësisht neni 191.1 të LPK-ës, kjo Gjykatë i vlerësoi si të paqëndrueshme për faktin se aktgjykimet e të dy gjykatave, as në dispozitiv, as në arsyetim nuk janë përfshirë nga këto shkelje, sepse dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm dhe nuk është në kundërshtim me arsyetimin, se të dy gjykatat kanë vlerësuar faktet relevante për një zgjidhje të drejtë të kësaj çështjeje juridike dhe se aktgjykimet e tyre përmbajnë arsye faktike dhe juridike për të gjitha faktet relevante që janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë.

Parashtrimet në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, parashikuar nga dispozita e nenit 204 të LPK-ës, pasi që nuk janë vlerësuar pretendimet ankimore lidhur me afatshmërinë e padisë, kjo Gjykatë i konsideron të pabazuara, sepse nuk përmbajnë ndonjë bazë të vlefshme juridike për marrjen e një vendimi më të favorshëm për të paditurin, për faktin se kërkesa kryesore e paditësit është realizimi i të drejtës për diferencën e pagës, se në këtë rast paditësi nuk është vonuar me paraqitjen e padisë, ngase kontesti kryesisht ka të bëjë me pagesën e diferencës së pagës si pasojë e një vendimi arbitrar e të kundërligjshëm të së paditurës për uljen e pagës, sepse për parashtrimin e kësaj kërkesë, në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, afti i parashkrimit është 3 vjet dhe jo ai që, siç pretendohet pa bazë në revizion, duhet llogaritur në përputhje me nenet 78 dhe 79 të Ligjit të Punës.

Parashtrimet e tjera në revizion kanë të bëjnë me konstatimin faktik dhe qëndrimet juridike të të dy gjykatave dhe prandaj nuk kanë ndikim për vendimmarrje në meritum të për çështjen.

Nga sa u parashtrua dhe në përputhje me nenin 222 lidhur me nenin 223.1 të LPK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Rev.nr. 64/2016, datë 4.4.2016

Kryetare e kolegjit

Gyltene Sylejmani